

DEKLARATË E “PLATFORMËS KOMBËTARE PËR GRATË”

9 nëntor 2011

Ne, gratë e Shqipërisë, si një pjesë e barabartë e shoqërisë, plotësisht të vetëdijshme për faktin se stereotipet gjinore janë ende të forta dhe të përhapura në shoqërinë tonë, dhe se pabarazitë gjinore janë më të dukshme në politikë, vendimmarrje, dhe në jetën publike, u bëjmë thirrje të gjitha partive politike, institucioneve publike në nivel qendror dhe lokal, medias dhe organizatave ndërkombëtare që:

1. Të sigurojnë mbështetje dhe njohuri politike, financiare dhe morale të mjaftueshme e sistematike për vazhdimin e veprimtarive të përbashkëta dhe të koordinuara, mbi rritjen e barazisë së grave dhe burrave në jetën politike dhe publike në Shqipëri.
2. Të luajnë një rol aktiv për të garantuar përfshirjen e plotë dhe përfaqësimin e grave në të gjitha nivelet e vendimmarrjes qendrore dhe lokale, bordet e kompanive publike dhe private, dhe në media.
3. Të përmirësojnë shanset e një përfaqësimi të ekuilibruar gjinor në masën 50 % si në Parlament, edhe në këshillat e bashkive dhe komunave, nëpërmjet një kuadri ligjor të përmirësuar. Në veçanti, në Kodin Zgjedhor mund të nevojitet unifikimi i nenit detyrues për përfaqësimin gjinor në mënyrë të tillë që një në çdo dy emra të ketë përkatësi gjinore të ndryshme, si për zgjedhjet parlamentare ashtu edhe për ato vendore.
4. Të mos certifikohen listat e partive politike që nuk përmbushin dispozitat e mësipërme.
5. Të sigurojnë përmes një detyrimi ligjor në Kodin Zgjedhor, publikimin e të dhënave të plota specifike gjinore për zgjedhjet parlamentare dhe ato vendore.
6. Të sigurojnë, duke ndryshuar Ligjin për Partitë Politike, përfshirjen e grave në strukturat vendimmarrëse të partive, si një garanci më shumë për promovimin e çështjeve gjinore në programet elektorale e statutet e partive.

Për një shoqëri dhe qeverisje të mirë, ku përfaqësimi i kujtdo prej nesh është një detyrë shoqërore dhe jo një privilegj, bashkohemi me të gjitha energjitë tona.